



Duke u bazuar në nenin 87, paragrafin 2, nënparagrafin 2.5 të Ligjit Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nxjerr:

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 01/2011/KRPP

Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të ofrojë interpretimin e paragrafit 3 të nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik, në mënyrë që të ua bëjë të qartë zyrtarëve të prokurimit të autoriteteve kontraktuese kërkesat e këtij paragrafi.

Neni 2 Shprehjet e përdorura

Shprehjet e përdorura në këtë udhëzues, kanë kuptimin e përkufizimeve të përcaktuara me nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-241 për Prokurimin Publik.

Neni 3 Komisioni për hapjen e tenderëve

Autoriteti kontraktues, obligohet të formojë komisionin e hapjes së tenderëve, i cili do të jetë numër tek, jo më pak se tre anëtarë dhe i udhëhequr nga zyrtari i prokurimit i autoritetit kontraktues.

Neni 4 Udhëzimet procedurale për hapjen e tenderëve

Gjatë procesit të hapjes së tenderëve, zyrtari i prokurimit i autoritetit kontraktues me rastin e hapjes së tenderëve, do t'u lexojë me zë atyre që janë të pranishëm **(i) emrin dhe vendin e tenderuesit, (ii) çmimin e përgjithshëm të tenderit të specifikuar në tenderin e tillë, përveç kur dokumenti përkatës është vetëm komponenti propozimit teknik të tenderit dy pjesësh dhe ndonjë vërejtje.**

Neni 5
Procesverbali i hapjes publike të tenderëve

Të gjitha informatat e lexuara sipas nenit 4 të këtij udhëzuesi do të regjistrohen në procesverbalin e hapjes publike të tenderëve, i cili do të nënshkruhet nga zyrtari përkatës i prokurimit, anëtarët e komisionit të hapjes dhe nga përfaqësuesi i secilit tenderues që janë të pranishëm. Procesverbali në fjalë do të përfshihet menjëherë në shënimet mbi aktivitetin e prokurimit sipas nenit 10.1 të këtij ligji dhe kopjet e procesverbalit në fjalë do t'u dërgohen menjëherë të gjithë tenderuesve.

Neni 6
Përfshirjet

Zyrtari përkatës i prokurimit nuk është i obliguar sipas këtij udhëzuesi dhe nuk kërkohet sipas paragrafit 3 të nenit 58 të këtij ligji, të lexojë zbritjen e ofruar nga tenderuesi me tenderin përkatës.

Neni 7
Obligimi i komisionit vlerësues

Komisioni vlerësues, gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve nuk do të marrë parasysh zbritjen e ofruar në përqindje nga tenderuesi me tenderin e tillë. Komisioni do të marrë në vlerësim çmimin e përgjithshëm të tenderuesit i cili është lexuar në procesin e hapjes së tenderëve.


Neni 8
Përgjegjësia e autoriteteve kontraktuese

Zyrtari i prokurimit dhe personat tjerë të autoritetit kontraktues që kanë marrë pjesë në procesin e hapjes publike të tenderëve dhe në procesin e vlerësimit, obligohen për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ, hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Dt. 11.03.2011
Prishtinë,


Safet Hoxha - Kryetar i KRPP